



492 27.04.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

1652

Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 27.04.2023

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.52


Datë: 26.04.2023

“Për miratimin e Programit të Punës “Për parandalimin, masat dhe ndërhyrjet që duhen marrë për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri, gjatë vitit 2023 ”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Afrim Mikli



Adresa: | Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com tel:0035521822935

Kapja



1652/1 (03/05/23)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.492/1 prot.

Peshkopi, më 03.05.2023

Lënda: Kthim vendimi për rishqyrtim.

Bashkisë

DIBËR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107 datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi verifikoi ligjshmërinë e vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.52 (pesëdhjetedy) datë 26.04.2023, për miratim Programi Pune, për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret, konstatova se :

Në zbatim të ligjit nr.45 datë 18.07.2019, "Për Mbrojtjen Civile", të nenit 30, shkronja ç, dh, të ligjit 57 datë 30.04.2020, "Për Pyjet", neni 30, pika 2, shkronja b, c, ku përcaktohet se; "Plani për Parandalimin dhe Shuarjen e Zjarreve për Sipërfaqet e Fondit Pyjor, hartohet i harmonizuar sipas përcaktimeve të ligjit nr.45/2019, "Për Mbrojtjen Civile", për të siguruar sistemin e monitorimit , të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në teritorin e tyre, të harmonizuara me planet e jashtme për emergjencat civile, të bashkisë dhe prefekturës.

Për këto arsye vendimi nr. 52 (pesëdhjetedy) datë 26.04.2023, kthehet për rishqyrtim duke kërkuar reflektimin e organit vendor në kushtet e respektimit të legjislacionit aktual në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e së drejtës.

Duke ju falenderuar për mirkuptimin.

P R E F E K T I
Nexhbedin SHEHU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 52 Datë 26.04.2023

“ Për miratimin e Programit të Punës “Për parandalimin, masat dhe ndërhyrjet që duhen marrë për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri, gjatë vitit 2023”


Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr.57/2020, “Për Pyjet”, të ligjit nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, të VKM-së nr.288, datë 27.06.2002 “Për përcaktimin dhe marrjen e masave kundër zjarrit dhe shpëtimin në objektet me rëndësi ekonomike dhe shtetërore”, VKM-së nr.835 datë 03.12.2004 “Për miratimin e planit kombëtar të emergjencave civile”, dhe VKM –së nr.1080 datë 22.12.2010 “Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota si dhe për krijimin e njëjësive vullnetare të shuarjes së zjarreve”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **26.04.2023**, me 19 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Të miratojë Programin e Punës “Për parandalimin, masat dhe ndërhyrjet që duhen marrë për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri, gjatë vitit 2023”, për fondin pyjor dhe kullosor në pronësi publike të Bashkisë Dibër.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pyjeve, Bashkia Dibër.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër
4. Vendimi u shpall me datë **26.04.2023**.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava



Adresa: | Bulevardi “Elez Isufi” Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com tel: 0035521822935



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E PYJEVE

Nr. 1426 Prot.

Peshkopi, më 06/06/2023

Lënda: Për miratimin e programit të punës për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarret, për vitin 2023.

Drejtuar: KRYETARIT TË BASHKISË DIBËR

Z. Rahim SPAHIU

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për miratim programin e punës për parandalimin, masat dhe ndërhyrjet që duhen marrë për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarret për vitin 2023.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Konceptoi: Ing. Ibrahim GJAPI

Pranoi: Ing. Vullnet TAFA

Miratoi: DREJTORI Gani SALKURTI



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E PYJEVE

Miratoi:

KRYETARI I BASHKISË



PROGRAM PUNE

"Për parandalimin, masat dhe ndërhyrjet që duhen marrë për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri"

Konceptoi:

Ing. Vullnet TAFA

Ing. Ibrahim GJAPI

Pranoi:

DREJTORI Gani SALKURTI

Viti, 2023

Drejtoria e Pyjeve pranë Bashkisë Dibër, në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", të Ligjit Nr. 57/2020, "Për Pyjet", të Ligjit Nr. 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", të VKM – së Nr. 288, datë 27.06.2002 "Për përcaktimin dhe marrjen e masave kundër zjarrit dhe shpëtimin në objektet me rëndësi ekonomike dhe shtetërore", VKM – së Nr. 835, date 03.12.2004 "Për miratimin e planit kombëtar të emergjencave civile" dhe të VKM – së Nr. 1080 datë 22.12.2010 "Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota si edhe për krijimin e njësisve vullnetare të shuarjes së zjarreve" merr këto masa organizative:

1. Në Drejtorinë e Pyjeve ngrihet shtabi i emergjencave të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH – së) me këtë përbërje:

NR.	EMRI MBIEMRI	FUNKSIONI	KONTAKT
1	Gani SALKURTI	Kryetar	069 568 7679
2	Vullnet Tafa	Anëtar	068 242 2064
3	Ibrahim Gjapi	Anëtar	069 522 5811
4	Kujtim EREQI	Anëtar	068 408 7169
5	Kristina KAPXHIU	Anëtar	068 405 7352
6	Orjol Kaza	Anëtar	067 998 4989
7	Xhemal BUCI	Anëtar	069 233 4498
8	Myrteza SELI	Anëtar	068 243 3088
9	Oliger Gjura	Anëtar	068 63 18277
10	Festim GJOÇI	Anëtar	068 561 6862
11	Elton KATA	Anëtar	068 567 0273
12	Muhamet ZENELHASANI	Anëtar	069 312 7700
13	Enco Gjura	Anëtar	068 233 1367
14	Elez Hysa	Anëtar	068 633 8445
15	Nexhip HOXHA	Anëtar	069 652 5550
16	Kujtim ÇIPURI	Anëtar	068 228 8383
17	Abaz Kaca	Anëtar	068 546 3673
18	Shpresim LLESHI	Anëtar	068 581 5040
19	Halil KURTI	Anëtar	068 843 8030
20	Melek ISKURTI	Anëtar	069 366 6444
21	Arshi MANJA	Anëtar	068 560 6987
22	Vladimir Hakorja	Anëtar	068 400 2383
23	Arnold HOXHA	Anëtar	068 642 6515

Ky shtab ngrihet dhe funksionon në nivel lokal dhe koordinon veprimet në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të bashkisë, organet e specializuara të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, të emergjencave civile, subjektet juridike dhe fizike, vendase dhe të huaja që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fondin pyjor dhe kullor.


2. Ngritjen në bashkëpunim me njësitë administrative e skuadrave vullnetare të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit për çdo fshat që ndodhet në brendësi apo në afërsi të zonave më të prekura pyjore me banorë me qëndrim të përhershëm në fshat dhe të përkushtuar.
3. Pranë shtabit të emergjencave vendoset shërbimi 24 orësh i gadishmërisë i cili do të jap e do të marrë informacionet e nevojshme në të gjitha nivelet për çdo rast zjarri duke përcaktuar masat përkatëse.
4. Njohja me bazën ligjore e nën ligjore e të gjithë subjekteve që ngarkohen me ligj, si edhe i atyre që ushtrojnë aktivitetin e tyre pranë zonave pyjore me rrezikshmëri të lartë për zjarret gjatë verës.
5. Organizimi i trajnimeve me grupe të ndryshme interesi në njësi administrative dhe fshatra, ndaj subjekteve që kanë kontrata me bashkinë, nxënës shkollash, barinj etj, mbi mënyrën e informimit dhe të organizimit në rast zjarri, si edhe nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në rastet kur ato shfaqen.
6. Vendosja në vende publike dhe të dukshme e posterave të ndryshëm me përmbajtje për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret dhe rritjen e vigjilencës ndaj tyre.
7. Çdo rast zjarri i shfaqur në fondin pyjor dhe kullor evidentohet duke plotësuar të gjithë dokumentacionin teknik, në të cilin përfshihen të gjithë elementët dhe fazat e zhvillimit të operacionit.
8. Bashkia nëpërmjet strukturave të saj vartëse do të mbajë në gadishmëri të plotë të gjithë bazën e saj materiale si veglat e punës, fikset, mjetet lëvizëse që ka në dispozicion për shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota.
9. Evidentimi i disa nga zonave më të prekshme nga zjarret e rëna ndër vite me qëllim shtimin e vëmendjes ndaj tyre për ti paraprirë situatave të mundëshme të rënies së zjarreve në pyje dhe kullota sipas tabelës bashkëngjitur:

Nr.	Zonat Pyjore	Ekonomia Pyjore	Njësia e qeverisjes vendore që mbulon territorin	Përbërja e grumbullit pyjor	Zona të rrezikshme ndër vite	Pikat dominante nga ku mund të vrojtohet	Vendi nga ku mund të furnizohet me ujë
1	Lurë	Lura "2"	Lurë	Rrob+pi+ah+arm +br	Kësule Lura, Vlashaj	Maja e Bakollimës	Liqenet e Lurës
2	Prat	Prat	Selishtë	Ah+du	Tolla, Derve, Guri i Arushës	Maja e Bilbilit, Maja e Shullanit të ri	Lumi Drin
3	Selishtë	Kacni	Selishtë	Pi+ah	Kacni, Mbi antenën e Albtelekomit	Maja e Runjës mbi Muhurr	Liqenet e Kacnisë
		Zhuri i Pllaut-Qafë-Murrë	Selishtë	Ah	Gryka e Zhurit të Pllaut	Maja e Runjës mbi Muhurr	Liqenet e Lurës
4	Sillovë	Kastriot Sillovë	Sillovë	Du	Lugje Prava	Maja e Runjës Lurë	Rezervuari i Shumbatit
5	Zall-Dardhë	Zall Dardhë Armollë	Arras, Zall-Dardhë	Ah	Mbi ish rep. të Tajanit	Maja e Pelpenikut	Liqeni i Madh Lurë

10. Ngritjen e skemës që do të funksionojnë në rast zjarri për informimin në kohë sa më të shpejtë dhe mënyrat e dhënjes e marrjes së informacionit.

SKEMA E NJOFTIMIT

në rast zjarri në pyjet bashkiakë





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E PYJEVE

Nr. 1425 Prot.

Peshkopi, më 06/09/2023

RELACION

Mbi projekt vendimin e paraqitur për miratimin e Programit të Punës "Për parandalimin, masat dhe ndërhyrjet që duhen marrë për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri, gjatë vitit 2023.

Pyjet dhe kullotat janë vazhdimisht të kërcënuara nga rënia e zjarreve, veçanërisht më të theksuara fenomene të tilla shfaqen në periudhën e nxehtë të vitit në stinën e verës. Duke qenë të hapura për publikun dhe përgjithësisht jashtë kontrollit permanent në çdo kohë nga autoritetet ligjzbatuese dhe në të cilin ushtrohen veprimtari të ndryshme që nga ato me karakter ekonomik por edhe eksplorues dhe rekreativ me qëllime pushimi dhe argëtimi, mundësitë për rënien e zjarreve në to janë të mëdha që nga pakujdesia e deri tek zjarrvënja e qëllimshme për arsye të ndryshme apo më rrallë edhe nga faktorë atmosferikë si shkarkimet nga rrufetë. Si të tilla zjarret në pyje konsiderohen si fatkeqësi me pasoja të rënda jo vetëm ekonomike me humbjen e materialit drusor të djegur por edhe të funksioneve mjedisore dhe ekologjike të tyre.

Drejtorja e Pyjeve pranë Bashkisë Dibër në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", të Ligjit Nr. 57/2020, "Për Pyjet", neni 30, pika c, ka përgatitur këtë program pune në lidhje me masat parandaluese si edhe ndërhyrjet që duhen realizuar për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri në bashkërendim me Njësitë Administrative, Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin (MZSH), të Emergjencave Civile në Bashki dhe strukturat e Policisë së Shtetit. Theksojmë se ky program pune është më shumë i karakterit teknik dhe sensibilizues, pa kosto shtesë financiare në buxhetin e bashkisë dhe që ka për qëllim bashkërendimin e punës me institucionet e mësipërme jo vetëm në parandalimin e rënies së zjarreve në fondin pyjor dhe kullosor por sidomos ndërhyrjen në shuarjen e tyre në rastet kur ato shfaqen.

Për sa më sipër me qëllim miratimin e këtij programi masash kërkojmë nga ana e Këshillit Bashkiak miratimin e projekt vendimit të paraqitur.

Konceptoi:

Ing. Vullnet Tafa

Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave.

DREJTORI

Gani SALKURTI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E PYJEVE

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ datë _____ / _____ / 2023

Për miratimin e Programit të Punës "Për parandalimin, masat dhe ndërhyrjet që duhen marrë për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri, gjatë vitit 2023".

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", të Ligjit Nr. 57/2020, "Për Pyjet", të Ligjit Nr. 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", të VKM – së Nr. 288, datë 27.06.2002 "Për përcaktimin dhe marrjen e masave kundër zjarrit dhe shpëtimin në objektet me rëndësi ekonomike dhe shtetërore", VKM – së Nr. 835, datë 03.12.2004 "Për miratimin e planit kombëtar të emergjencave civile" dhe të VKM – së Nr. 1080 datë 22.12.2010 "Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota si edhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve", Drejtoria e Pyjeve Bashkia Dibër:

PROPOZON:

1. Të miratojë Programin e Punës "Për parandalimin, masat dhe ndërhyrjet që duhen marrë për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri, gjatë vitit 2023" për fondin pyjor dhe kullosor në pronësi publike të Bashkisë Dibër.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pyjeve në Bashki.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Dibër.

Për Bashkinë Dibër

Juristja e Bashkisë

Elona LUSHA

Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave


Ing. Vullnet Tafa

DREJTORI

Gani SALKURTI

KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHËU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT
TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga BA DIBËR dhe mban nga dërguesi nr 492/1 prot
date: 0305.2023 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes (lënda)

Praktika shkresore u protokoillua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr. hyrës prot 1652/1 datë 0805.2023

Praktika u drejtohet për administrim:

-Znj/Z

-Znj/Z

-Znj/Z

-Znj/Z

me porosinë:

Administratori praktikës sipas Spj

Afat i përgatitjes së praktikës shkresore (përgjigjes, etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë sipas afatit

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore:

Peshkopi, më 0805.2023

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS